



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Mekanizmat e sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Grantin e Performancës Komunale për vitin 2021

Prishtinë, shkurt 2024

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, të cilit Kushtetua dhe Ligji¹ i garantojnë pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra Kombëtare e Auditimit, që kryesohet nga Auditori i Përgjithshëm, e ndihmon në kryerjen e detyrave të tij/saj. Së bashku kontribuojnë në mënyrë efektive në llogaridhënien e sektorit publik, duke promovuar transparencën publike dhe qeverisjen e mirë, dhe duke nxitur ekonominë, efektivitetin dhe efikasitetin e programeve qeveritare për të mirën e të gjithëve.

Auditori i Përgjithshëm i jep llogari Kuvendit për ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligj, në aktet nënligjore dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare. Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 30001²).

Auditimet e performancës të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë³, efikasitetit⁴ dhe efektivitetit⁵ dhe nëse ka vend për përmirësim.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me përmbajtjen e raportin të auditimit “Mekanizmat e sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Grantin e Performancës Komunale për vitin 2021” në konsultim me Ndhmës Auditoren Përgjithshme, Myrvete Gashi, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që e realizoi këtë raport:

Fatlinda Ramosaj, Drejtor i auditimit
Vjosë Bojku, Udhëheqës i ekipit;
Shqipe Mujku, Anëtare e ekipit; dhe
Lirak Mulliqi, Anëtarë i ekipit.

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT – Adresa: Lagjja Arbëria, Rr. Ahmet Krasniqi nr. 210, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 (0) 38 60 60 04
<http://zka-rks.org>

¹ Ligji 05_L_055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës

² Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s dhe përvoja praktike

³ Ekonomia - Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së burimeve. Burimet e përdorura duhet të jenë në dispozicion në kohën e duhur, në sasinë dhe cilësinë e duhur dhe në çmimin më të mirë të mundshëm.

⁴ Efikasiteti - Parimi i efikasitetit nënkupton marrjen e maksimumit nga burimet në dispozicion. Ka të bëjë me lidhjen mes burimeve të përfshira dhe rezultatit të dhënë në aspektin e sasisë, cilësisë dhe kohës.

⁵ Efektiviteti - Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritshme.

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje e përgjithshme.....	i
1 Hyrje	1
2 Objektiva dhe pyetjet e auditimit	2
2.1.1 Pyetjet e auditimit.....	2
3 Gjetjet e auditimit.....	3
3.1 Efektiviteti i kontrolleve të brendshme në vlerësimin e dokumenteve të raportuara për performancë komunale	3
3.1.1 Mekanizmat e sigurimit të cilësisë brenda komunave	4
3.1.2 Mekanizmat e sigurimit të cilësisë nga Ministria për vlerësimin e Performancës Komunale dhe Grantit të Performancës Komunale.....	4
3.1.3 Vlerësimi i 27 treguesve për Performancë Komunale	6
3.1.4 Procesi i ankesave për vlerësimin e performancës komunale.....	10
3.1.5 Vlerësimi i Grantit të Performancës Komunale nga grupi teknik	11
3.1.6 Verifikimi në terren pas afateve kohore të parapara	16
3.2 Ministria ka mangësi në menaxhimin e autorizimeve për qasje në SMPK	17
3.2.1 Mangësi në menaxhimin e fjalëkalimeve në SMPK.....	19
3.2.2 Kufizimi i raportimit të performancës komunale sipas SMPK	19
4 Konkluzionet	21
5 Rekomandimet	22
Shtojca I Kriteret, fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	24
Shtojca II Tabelat e krahasimit të vlerësimin mes Ministrisë dhe ZKA-së.....	28
Shtojca III - Matja e 27 treguesve në Performancë Komunale	31
Shtojca IV Letër konfirmimet e komunave	34
Shtojca V Letër konfirmimi dhe komentet nga Ministria	37

Lista e shkurtesave

AK	Autoritet Kontraktues
DEMOS	Decentralization and Municipal Support
DPTK	Departamenti i Performancës dhe Transparencës Komunale
LPP	Ligji për Prokurim Publik
Ministria	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
OE	Operator Ekonomik
SMPK	Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

Përmbledhje e përgjithshme

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e performancës me temën “Mekanizmat e sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Grantin e Performancës Komunale për vitin 2021”.

Qëllimi i këtij auditimi është vlerësimi i efektivitetit të mekanizmave për sigurimin e cilësisë së të dhënave të raportuara të Performancës Komunale dhe Grantit të Performancës Komunale si dhe vlerësimi se si është menaxhuar qasja logjike në Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale për Komunitet: Gjakovë, Klinë dhe Viti. Po ashtu, kemi vlerësuar se si është bërë verifikimi dhe vlerësimi i këtij procesi nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Nga 38 komunitet në Republikën e Kosovës vetëm gjashtë prej tyre kanë përbushur kushtet minimale dhe janë kualifikuar për grantin e performancës komunale për vitin 2023. Granti i performancës komunale për vitin 2023 është bashkë-financuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Bashkimi Evropian, Suedia, Zvicra dhe Norvegjia. Vlera e grantit të ndarë ishte 7,850,000 euro.

Ministria nuk ka arritur të sigurojë kontrolle efektive të cilat ndikojnë edhe në renditjen përfundimtare të performancës së komunale. Dështimi i Ministrisë për të kryer vlerësime paraprake, pranimit të dokumenteve të pa protokolluara dhe mospërputhjet në pikët e dhëna kanë komprometuar efektivitetin e mekanizmave që synojnë të sigurojnë cilësi në raportimin e performancës komunale. Këto të meta, kanë ndikuar edhe në renditje jo të drejtë të komunave të audituara.

Cilësia e raportimit të performancës komunale nuk është në nivel të duhur. Përkundër përpjekjeve të komunave për organizimin e brendshëm dhe raportimin e performancës komunale, mangësitë në komunikim, proceset e miratimit dhe shpërndarjen e detyrave i kanë bërë mekanizmat e kontrollit për sigurimin e cilësisë të paefektshëm. Mungesa e dëshmive të komunikimit dhe miratimit nga zyrtarët përgjegjës rrezikon besueshmërinë e të dhënave të raportuara.

Veprimet e komisioneve vlerësuese rrezikojnë transparencën dhe besueshmërinë në menaxhimin e performancës komunale. Devijimet nga vendimet e marra nga komisionet vlerësuese, duke përfshirë përfshirjen e paautorizuar të pjesëmarrësve dhe mungesën e votuesve të autorizuar, tregojnë që transparenca dhe besueshmërinë e proceseve të Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale nuk është në nivel të kënaqshëm. Këto devijime cenojnë integritetin e të gjithë kornizës së vlerësimit.

Ministria nuk ka arritur që të sigurojë qasje për personat e autorizuar në sistem. Ministrisë nuk ka arritur të zbatojë kontrollet e duhura të qasjes në sistem, për të harmonizuar funksionalitetet e sistemit me rregulloret dhe për të zbatuar masat e konfidencialitetit në sistemin SMPK duke u ekspozuar në rreziqe të sigurisë. Mangësitë në praktikën e menaxhimit të llogarive, duke përfshirë llogaritë e pa personalizuara dhe mungesa e respektimit të standardeve të menaxhimit të fjalëkalimeve, komprometojnë më tej integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave të komunave.

Përgjigja e palëve të përfshira në auditim

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal nuk është pajtuar me gjetjet dhe rekomandimet andaj detajet e komenteve dhe letër konfirmimin që nuk janë pajtuar gjenden në shtojcën V, ndërsa tre komunat e audituara janë pajtuar me gjetjet dhe rekomandimet e auditimit. Letër konfirmimet për pranimin e gjetjeve dhe rekomandimeve për Komunat Gjakovë, Klinë dhe Viti mund t'i gjeni në shtojcën IV. Inkurajojmë institucionet e përfshira në këtë auditim që të bëjnë të gjitha përpjekjet për të adresuar rekomandimet e dhëna.

1 Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit nga viti 2018 ka filluar bashkëpunimin me Helvetas/DEMOS. Katër auditimet e publikuara si rrjedhojë i këtij bashkëpunimi kishin për qëllim vlerësimin e komunave lidhur me zhvillimin e procedurave të prokurimit, menaxhimin e projekteve dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Përveç këtyre, në auditimin e fundit është vlerësuar edhe ndikimi apo menaxhimi i këtyre granteve si tërësi dhe dallimet mes pjesës së financimit nga Helvetas/DEMOS dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (tutje Ministria).

Në këtë auditim, fokusi është në procesin e funksionalitetit të mekanizmave të kontrollit të cilësisë të vendosura në komuna, vlerësimin e procesit të performancës komunale për Grantin e Performancës Komunale (tutje GPK), dhe përdorimin e Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale (sistemin elektronik dhe qasjet në të-tutje SMPK).

Pavarësisht progresit në zhvillimin dhe funksionimin e Performancës Komunale, matja e saj, saktësia e informatave, vlerësimi i tërësishëm i procesit dhe përdorimi i softuerit/qasja në SMPK mbetet ende sfidë e akterëve të përfshirë në këtë proces.

Gjatë zhvillimit të aktiviteteve të përditshme, komunat ballafaqohen me sfida të ndryshme qoftë në ngritjen e performancës, në ngritjen e nivelit të kënaqshmërisë së pranuesve të shërbimeve dhe përmirësimin e produktivitetit dhe efikasitetit në ofrimin e këtyre shërbimeve.

Matja e performancës komunale ka për qëllim që vetë komunat, Ministria, qytetarët dhe të gjitha palët e interesit të kuptojnë se deri në çfarë shkalle komunat kanë arritur të ofrojnë shërbime në kohën dhe cilësinë e duhur, në funksion të përmirësimit të jetës së qytetarëve.

SMPK përfaqëson një instrument të rëndësishëm për vëzhgimin e respektimit të të drejtave dhe detyrimeve të organeve të pushtetit lokal gjatë ofrimit të shërbimeve për qytetarët, të përcaktuara me politikat, prioritetet dhe rregullativën përkatëse ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Qëllimi i përgjithshëm i Grantit të Performancës Komunale është nxitja e komunave për të përmirësuar proceset e qeverisjes, të cilat së bashku me kornizën e politikave të përmirësuara çojnë në ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët.

Në vazhden e iniciativave dhe bashkëpunimit me Helvetas/DEMOS, ZKA ka vendosur të kryejë këtë auditim, në mënyrë që të kontribuoj në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies ndaj tatimpaguesve dhe palëve të interesit.

2 Objektiva dhe pyetjet e auditimit

Përmes këtij auditimi, ne kemi vlerësuar efektivitetin e mekanizmave për sigurimin e cilësisë së të dhënave të raportuara të Performancës Komunale dhe Grantit të Performancës Komunale si dhe vlerësimin se si është menaxhuar qasja në Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale.

2.1.1 Pyetjet e auditimit

Për t'ju përgjigjur objektivës së auditimit, ne kemi parashtruar pyetjet në vijim:

1. A janë efektive kontrollet për vlerësimin e dokumenteve të raportimit të performancës komunale?

2. A ka siguruar Ministria kontrolle se vetëm përdoruesit e autorizuar ndaj informacioneve kanë qasje në Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale?

Ky auditim ka mbuluar procesin e vlerësimit të mekanizmave për kontrollin e cilësisë së të dhënave të raportuara për performancën e vitit 2021, ku vlerësimi është kryer në vitin 2022, ndërsa mjetet janë ndarë gjatë vitit 2023. Ne, me këtë auditim kemi mbuluar tre komuna: Gjakovë, Klinë dhe Viti si përfituese të Grantit të Performancës Komunale për vitin 2021 dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si monitoruese dhe vlerësuese e këtij procesi.

Metodologjia e detajuar e aplikuar gjatë këtij auditimi, nën-pyetjet e auditimit kriteret e auditimit dhe fushëveprimi i auditimit janë paraqitur në Shtojcën I.

3 Gjetjet e auditimit

Vlerësimi i performancës komunale për vitin 2021 kishte nxjerrë fituese për GPK gjashtë komuna. Vlera e grantit të ndarë për vitin 2023 ishte 7,850,000 euro. Ne kemi audituar tre prej komunave të cilat ishin përfituese të 40% të shumës së GPK për vitin përkatës.

3.1 Efektiviteti i kontrolleve të brendshme në vlerësimin e dokumenteve të raportuara për performancë komunale

Komunat janë përgjegjëse për të krijuar parakushtet për funksionimin efikas të SMPK-së, duke siguruar bashkëpunimin me Ministrinë, mbledhjen, raportimin, verifikimin dhe miratimin e të dhënave për performancën e komunës⁶.

Niveli i parë i sigurimit dhe raportimit të të dhënave nga komunat, janë zyrtaret komunal për raportim. Pas pranimit të njoftimit nga Ministria, koordinatori iu kishte dërguar njoftim zyrtarëve komunal për raportim të përfshirë në procesin e deklarimit të performancës komunale lidhur me fillimin e procesit të deklarimit. Njoftimi i dërguar zyrtarëve nga koordinatori është praktik që e kemi hasur vetëm në Komunën e Gjakovës, , ndërsa në Komunat Klinë dhe Viti nuk na janë ofruar dëshmi se një proces i tillë që ka ndodhur.

Sipas zyrtarëve përgjegjës, mos dokumentimi i aktiviteteve koordinuese si një nga parakushtet për deklarimin e performancës komunale kishte ndodhur pasi që ata i kishin fshirë të gjitha komunikimet elektronike të vitit 2021 me arsyetimin e ngarkesës së emailit. Mos ruajtja apo mos arkivimi i komunikimit mes zyrtarëve përgjegjës, tregon se sa pak rëndësi i është dhënë këtij procesit të koordinimit, kontrollit dhe monitorimit nga komunat.

Në vitin 2021, Komuna e Gjakovës në procesin e deklarimit të performancës komunale kishte të përfshirë 16 zyrtarë raportues dhe koordinatorin. Ndërsa në Komunën e Klinës dhe Vitisë ishin të përfshirë nga 14 zyrtarë raportues dhe koordinatori.

Ne kemi gjetur se në komunat e audituara nuk kishte shpërndarje proporcionale të fushave për raportim brenda zyrtarëve të angazhuar. Kjo pasi që një zyrtar ishte i angazhuar me katër respektivisht pesë fusha për raportim ndërsa zyrtarët tjerë në proces kishin vetëm nga një fushë për raportim. Megjithatë, disa fusha kanë më shumë tregues se disa tjera dhe shpërndarja e detyrave ishte bërë në përputhje me pozitat e rregullta të punës së zyrtarëve dhe numrit të treguesve nëpër fusha.

Një arsye që mund të vështirësoj procesin e raportimit, për zyrtarët që kanë nën përgjegjësi shumë tregues, është fakti se këta zyrtarë duhet të angazhohen edhe në mbledhjen e të dhënave nga kompanitë publike të cilat operojnë në komunën respektivisht regionet e tyre.

⁶ Rregullorja 01/2020 për menaxhimin e sistemit të performancës komunale dhe Grantit për Performancë Komunale

3.1.1 Mekanizmat e sigurimit të cilësisë brenda komunave

Organet përgjegjëse në komunë për verifikimin e saktësisë së të dhënave janë koordinatori dhe kryetari i komunës i cili siguron se janë përmbushur të gjitha kriteret për sigurinë e cilësisë së të dhënave. Kryetari i Komunës është instanca më e lartë vendimmarrëse për SMPK në nivelin komunal, i cili me vendim cakton koordinatorin dhe zyrtarët komunal për raportim të performancës komunale, gjithashtu bën miratimin e tërësisë së të dhënave për performancë komunale para raportimit në Ministri.

Niveli i dytë në komunë i përfshirë në procesin e performancës komunale është koordinatori i cili sipas vendimit është përgjegjës për pranimin e raporteve nga çdo sektor dhe të analizojnë të njëjtat raporte bashkë me zyrtarët raportues. Këto raporte përcjellën si raporte përfundimtare për aprovim tek Kryetari i Komunës, dhe pas këtij aprovimi raporti përcjellët në Ministri.

Procesi se si funksionon komunikimi mes koordinatorit dhe zyrtarëve raportues përgjegjës në komunat e audituara është i rregulluar me vendim të kryetarit të komunës përkatëse. Ky vendim i jep përgjegjësinë koordinatorit që të jetë hallka rregulluese dhe monitoruese e gjithë procesit të raportimit dhe monitorimit të të dhënave për performancën komunale.

Procesi i komunikimit mes koordinatorit dhe zyrtarëve raportues ishte i tëri në formë verbale dhe nuk është dokumentuar. Ne nuk kemi gjetur në asnjërin nga tre komunat e audituara dëshmi lidhur me procesin e verifikimit dhe kontrollit të cilësisë brenda komunës nga zyrtari për performancë komunale kundrejt drejtorive përkatëse, e po ashtu, as mes zyrtarëve raportues dhe koordinorëve. Kjo kishte ndodhur sepse ata kanë konsideruar si mënyrë më të lehtë dhe më efikase komunikimin verbal.

Për më tepër, pas përfundimit të raportimit nga zyrtarët raportues dhe koordinatorit në komunat e audituara, kemi gjetur se miratimi i të dhënave bëhet nga koordinatori, në vend së të bëhet nga kryetarët e komunave. Bartja e përgjegjësisë së tillë nga Kryetarët tek koordinorët, nuk është i mbështetur me ndonjë vendim që e autorizon koordinatorin.

Shkak për këtë, ishin angazhimet e shumta të kryetarëve. Mungesa e miratimit të të dhënave nga kryetarët është dëshmi që kontrollet e brendshme nuk kanë funksionuar dhe anashkalimi i hapit kryesor dhe përfundimtar i miratimit të të dhënave mund të ndikoj në zbehjen e cilësisë së të dhënave të raportuara.

3.1.2 Mekanizmat e sigurimit të cilësisë nga Ministria për vlerësimin e Performancës Komunale dhe Grantit të Performancës Komunale

Ministria është përgjegjëse për verifikimin e të dhënave pas raportimit të komunave dhe ky proces duhet të përfundoj para procedurës së konsultimit paraprak, njësia për performancë është përgjegjëse për hartimin e raportit për procesin e verifikimit të dhënave. Formë tjetër e verifikimit mund të aplikohet në pajtim me Dokumentin Kryesor për SMPK. Në këtë fazë MAPL-ja në bashkëpunim me komunat mund të përmirësoj të dhënat për të cilat janë raportuar gabimisht dhe komunat kanë fakte lidhur me ndryshimin, ky proces ndodh gjatë fazës së konsultimit paraprak.

Njoftimi i Ministrisë drejtuar komunave për deklarimin e performancës komunale duhet të bëhet të paktën shtatë ditë para hapjes së sistemit.

Në vitin 2021, Ministria e kishte dërguar vendimin në datën 31 mars (vetëm një ditë përpara) dhe i kishte informuar komunat që nga 1 prilli deri me 16 maj është afati zyrtar për raportim. Ky afat i raportimit sipas rregullores në fuqi është 45 ditë.

Si rezultat i njoftimit me vonesë siç kërkohet shtatë ditë përpara hapjes së sistemit tu dërgohet komunave dhe nevojës për fillim të menjëhershëm të raportimit, komunat nuk kishin arritur të raportojnë performancën komunale në ditët e para të përcaktuara për raportim. Kjo kishte ndikuar që komunat të kërkojnë afat shtesë prej 15 ditësh pas datës së fundit për raportim, pra që sistemi të ua lejojë komunave raportimin deri me 31 maj 2022.

Shkresa e cila ua aprovonte afatin shtesë komunave ishte dërguar nga udhëheqësi i divizionit përmes një email-i drejtuar kryetarëve të komunave dhe koordinatorëve komunal dhe jo me vendim të sekretarit siç është përcaktuar me rregullore⁷.

Njoftimi me vonesë i komunave dhe mos gatishmëria e komunave për të raportuar në kohën e paracaktuar ka ndikuar që të shfrytëzohet edhe 15 ditëshi shtesë për deklarimin e performancës komunale. Zgjatja e afateve kohore për deklarimin e performancës komunale ka ndikuar edhe në të gjitha proceset vijuese duke e përfshirë edhe procesin përfundimtar, pra ndarjen e Grantit.

Vlerësimi i performancës komunale

Njësia përgjegjëse për performancë siguron se janë përmbushur të gjitha kriteret për pranimin e të dhënave të raportuara nga komunat përkatësisht të dhënat a janë raportuar brenda afatit kohor të caktuar nga Ministria dhe janë respektuar kriteret për raportim përfshirë nënshkrimet apo autorizimet e zyrtarit komunal për performancë, koordinatorit për performancë dhe kryetarit të komunës.

Pas mbylljes së afatit për raportim nga komunat, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë me anë të vendimit ka themeluar komisionin për vlerësimin dhe verifikimin e të dhënave të raportuara nga komunat për vitin 2021.

Komisioni kishte në përbërje katër anëtarë nga Ministria dhe tre anëtarë/përfaqësues nga projekti Helvetas/DEMOS.

Komisioni kishte filluar me procesin e vlerësimit pa verifikuar se ishin respektuar të gjitha kriteret, përfshirë edhe miratimin apo jo të të dhënave nga kryetarët e komunave. Ne kemi gjetur se nga 38 komuna që kanë deklaruar për performancën komunale, në 22 prej tyre, kryetarët e komunave i kanë miratuar të dhënat ndërsa në 16 prej tyre nuk ka ndodhë një proces i tillë.

⁷ Rregullorja 01/2020 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës komunale dhe Grantit të Performancës Komunale, Neni 13 pika 6

Dy nga Kryetarët e tri komunave të audituara nuk kishte bërë miratimin e të dhënave të raportuara. Kjo kishte ndodhë në mungesë të menaxhimit të duhur të procesit të vlerësimi në Ministri, pasi që komisioni nuk kishte verifikuar nëse të dhënat ishin miratuar nga ana e kryetarëve.

Mangësi tjetër që kishte shoqëruar Ministrinë gjatë vlerësimit të vitit 2021, ishte anashkalimi i procesit të verifikimit i cili realizohet pas raportimit të komunave dhe duhet të përfundoj para procedurës së konsultimit paraprak, proces ky, që komunave do t'u ndihmonte në përmirësimin e raportimit të rezultateve të performancës komunale dhe automatikisht rezultateve më të mira në GPK.

3.1.3 Vlerësimi i 27 treguesve për Performancë Komunale

Matja e performancës komunale organizohet në baza të rregullta vjetore nga Ministria. Ministria është përgjegjëse për Menaxhimin e Sistemit për Performancë Komunale dhe Grantit për Performancë Komunale.

Në vlerësimin e performancës komunale për vitin 2021, Ministria në harmoni me kërkesat e Dokumentit Kryesor, kishte vlerësuar 19 fusha me 119 tregues për procesin e performancës komunale, ndërsa për ndarjen e Grantit të Performancës Komunale për vitin 2023 kishte vlerësuar 27 tregues.

Në mënyrë që të analizojmë procesin se si Ministria kishte bërë vlerësimin e performancës komunale, ne kemi përzgjedhur 27 treguesit e vlerësimit për ndarjen e GPK-së dhe kemi analizuar se si janë vlerësuar të njëjtit në procesin e vlerësimit dhe verifikimit të performancës komunale për vitin 2021.

Komunat gjatë deklaramentit të performancës komunale e kanë edhe mundësinë e vetëvlerësimit të secilit tregues në sistem. Pas përfundimit të afateve të deklaramentit, monitorimit, verifikimit paraprak dhe shqyrtimit të ankesave në procesin e performancës komunale, Ministria vendosë rezultatet finale në sistem dhe i njofton komunat për këto rezultate. Zyra Kombëtare e Auditimit (tutje ZKA) ka bërë verifikimin e dëshmimeve për këta tregues dhe ka vlerësuar se a janë siç kërkohet me rregullat/kriteret e dokumentit kryesor për secilën të dhënë se me çfarë dokumenti duhet të dëshmohet.

Më poshtë kemi paraqitur fushat dhe dallimin në vetëvlerësim nga komunat, vlerësimin nga Ministria dhe vlerësimin nga ZKA-ja për treguesit në procesin e matjes së performancës komunale për komunat e audituara. Detajet e plota të tabelave gjenden në shtojcën e II.

Tabela 1, Komuna e Gjakovës

Përgjegjshmëria Komunale		Gjakove		
I. Roli I kuvendit komunal si organ mbikqyres		MAPL	Komunë	ZKA
Treguesi : 3.2.6	Mbledhje të Kuvendit me pjesëmarrje të kryetarit të komunës	100	100	0
II. Pjesëmarrja, konsultimi dhe gjithëpërfshirja e qytetarëve				
Treguesi : 3.1.4	Dëgjime publike për KAB dhe buxhet komunal	100	100	0
III. Transparenca, qasja në informata dhe integriteti				
II. MENAXHIMI KOMUNAL - Menaxhimi financiar, Menaxhimi i kontratës dhe Menaxhimi i BNJ				
IV. Menaxhimi Financiar				
V. Menaxhimi i Kontratave				
Treguesi : 3.3.1	Niveli i zbatimit të planit të prokurimit	67.99	67.99	133.24
Treguesi : 19.1.2	Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim	0	100	0
VII. Shërbimet administrative				
Treguesi : 15.1.2	Lejet mjedisore komunale të lëshuara	92.3	92.3	0
VIII. Planifikimi hapësinor, transporti publik dhe mjedisi				
Treguesi : 10.1.2	Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik	63.73	63.73	0

Komuna e Gjakovës nga 11 treguesit e vlerësuar të fushës së përgjegjshmërisë komunale, tre prej tyre nuk i kishte mbështetur me dëshmitë e duhura. Tek treguesi 3.2.6 (Mbledhje të Kuvendit me pjesëmarrje të kryetarit të komunës), Komuna e Gjakovës nuk kishte ngarkuar asnjë dokument në asnjërën nga të dhënat e kërkuara, dhe pavarësisht kësaj Ministria kishte vlerësuar këtë tregues me 100 pikë.

Në treguesin 3.1.4, Komuna e Gjakovës në dy nga tri të dhënat e kërkuara kishte bashkangjitur dokumente të pavullosura dhe të pa protokolluara ndërsa tek e dhëna e tretë e këtij treguesi kishte ngarkuar link të pa referencuar.

Tek treguesi 3.3.1 (niveli i zbatimit të planit të prokurimit), komuna e po ashtu edhe Ministria kishin vlerësuar bazuar në vlerën e parashikuar të kontratave dhe vlerën e kontratave të nënshkruara nga lista e kontratave të nënshkruara, e jo sipas shumës së shpenzuar kundrejt asaj të planifikuar në fillim të vitit me planin e prokurimit, siç kërkohet me dokumentin kryesor.

Sa i përket transportit publik, Komuna e Gjakovës nga dy treguesit e vlerësuar të kësaj fushe, njërin nga ta nuk e kishte mbështetur me dëshmitë që kërkohen sipas dokumentit kryesor. Tek treguesi 10.1.2 (Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik), komuna tek e dhëna 1 kishte bashkangjitur dokument jo të duhur, më specifikisht kishte bashkangjitur dokumentin “Statuti i Komunës së Gjakovës” ku nuk gjendet numri i vendbanimeve për këtë komunë (e dhënë kjo që kërkohet sipas dokumentit kryesor).

Sa i përket mbrojtjes së mjedisit, treguesi 15.1.2. (Lejet mjedisore komunale të lëshuara), Komuna e Gjakovës treguesin e vetëm që vlerësohet për këtë fushë, nuk ka arritur që të mbështes me dëshmitë e duhura pasi kishte vendosur dokument të pa vullosura dhe të pa protokolluara.

Tabela 2, Komuna e Klinës

Përgjegjshmëria Komunale		Kline		
		MAPL	Komunë	ZKA
I. Roli I kuvendit komunal si organ mbikqyres				
Treguesi : 3.2.2	Diskutime për raportet buxhetore tre-mujore nga Kuvendi Komunal	100	100	0
Treguesi : 3.2.6	Mbledhje të Kuvendit me pjesëmarrje të kryetarit të komunës	55.55	90	55.55
II. Pjesëmarrja, konsultimi dhe gjithëpërfshirja e qytetarëve				
Treguesi : 3.1.3	Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun	100	100	50
II. MENAXHIMI KOMUNAL - Menaxhimi financiar, Menaxhimi i kontratës dhe Menaxhimi i BNj				
V. Menaxhimi i Kontratave				
Treguesi : 3.3.1	Niveli i zbatimit të planit të prokurimit	100	100	119.22

Te përgjegjshmëria komunale, Komuna e Klinës nga 11 treguesit e vlerësuar, katër prej tyre nuk i kishte mbështetur me dëshmitë që kërkohen sipas dokumentit kryesor.

Tek treguesi 3.1.3 (Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun), komuna nuk kishte bashkangjitur asnjë dokument në asnjërën të dhënë të kërkuar.

Në treguesin 3.2.2 (Diskutime për raportet buxhetore tre-mujore nga Kuvendi Komunal), ku kërkohen diskutimet për raportet buxhetore tre-mujore të vitit raportues, komuna kishte bashkangjitur raporte gjashte mujore apo nëntë mujore apo raportin vjetor të buxhetit dhe nuk kishte bashkangjitur raportet tre mujore në asnjërën nga katër të dhënat e kërkuara.

Në treguesin 3.2.6 (Mbledhje të Kuvendit me pjesëmarrje të kryetarit të komunës), Komuna nuk kishte bashkangjitur fare dokument tek e dhëna 1.

Për treguesin 3.3.1 (Niveli i zbatimit të planit të prokurimit), Komuna e Klinës dhe vet Ministria kishin ndjekur praktiken e njëjtë me atë të Komunës së Gjakovës, duke vlerësuar bazuar në vlerën e parashikuar të kontratës dhe vlerën e kontratave të nënshkruara nga lista e kontratave të nënshkruara, e jo sipas shumës së shpenzuar kundrejt asaj të planifikuar në fillim të vitit me planin e prokurimit.

Tabela 3, Komuna e Vitisë

Përgjegjshmëria Komunale		Viti		
		MAPL	Komunë	ZKA
I. Roli i kuvendit komunal si organ mbikqyres				
Treguesi : 3.2.2	Diskutime për raportet buxhetore tre-mujore nga Kuvendi Komunal	75	75	0
Treguesi : 3.2.6	Mbledhje të Kuvendit me pjesëmarrje të kryetarit të komunës	66.66	66.66	0
Treguesi : 3.1.2	Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike	32.84	32.84	0
Treguesi : 3.1.4	Dëgjime publike për KAB dhe buxhet komunal	100	100	0
III. Transparenca, qasja në informata dhe integriteti				
II. MENAXHIMI KOMUNAL - Menaxhimi financiar, Menaxhimi i kontratës dhe Menaxhimi i BNJ				
V. Menaxhimi i Kontratave				
Treguesi : 19.1.2	Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfry	100	100	0
III. OFRIMI I SHËRBIMEVE - Qasja dhe cilësia e ofrimit të shërbimeve - Sipas sektorit				
VII. Shërbimet administrative				
Treguesi : 15.1.2	Lejet mjedisore komunale të lëshuara	80	80	0
VIII. Planifikimi hapësinor, transporti publik dhe mjedisi				
Treguesi : 10.1.2	Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik	51.28	51.28	0
IX. Arsimiti para-universitar				
Treguesi : 17.3.5	Kalueshmëria në maturën kombëtare kl.12-të (ndarja sipas gjinisë)	61.88	61.88	0

Komuna e Vitisë në fushën e përgjegjshmërisë komunale, nga 11 treguesit e vlerësuar, katër prej tyre nuk i kishte mbështetur me dëshmitë që kërkohen sipas dokumentit kryesor.

Tek treguesi 3.1.2 (Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike), Komuna e Vitisë nuk kishte bashkangjitur dëshmitë për mbajtjen e takimeve publike nga ana e komunës, veçmas për secilin takim, dhe regjistrat me evidencën e pjesëmarrësve, ashtu siç kërkohen tek e dhëna 1 e këtij treguesi sipas dokumentit kryesor. Në vend të këtyre, komuna kishte bashkangjitur vetëm një dokument të lëshuar nga zyra për informim dhe marrëdhënie me publikun ku ceket vetëm numri i pjesëmarrësve në takime publike.

Për treguesin 3.1.4 (Dëgjime publike për KAB dhe buxhet komunal), Komuna e Vitisë tek e dhëna 1 kishte bashkangjitur dokument jo relevant siç është raporti narrativ i diskutimeve me publikun, e jo numri i dëgjimeve për buxhetin vjetor komunal, i cili duhet të dëshmohet nëpërmjet procesverbaleve, njoftimeve apo rrethimeve të ditës së konsultimeve dhe me aktet komunale të miratuara dhe publikuara të komunës.

Tek e dhëna 3.2.2 (Diskutime për raportet buxhetore tre-mujore nga Kuvendi Komunal), Komuna e Vitisë kishte bashkangjitur raporte gjashtë mujore apo vetëm ftesa të mbledhjeve të seancave të kuvendit dhe nuk kishte bashkangjitur raportet tre mujore në asnjërin nga katër të dhënat e kërkuara, ku sipas dokumentit kryesor kërkohen diskutimet për raportet buxhetore tre-mujore për secilën nga katër periudhat tre mujore të vitit raportues.

Për treguesin 3.2.6 (Mbledhje të Kuvendit me pjesëmarrje të kryetarit të komunës) Komuna e Vitisë, tek e dhëna 1 ku kërkohet dëshmi mbi numrin e mbledhjeve të kuvendit ku ka marrë pjesë kryetari i komunës, nuk kishte bashkangjitur dëshmi relevante, por në vend të këtyre kishte bashkangjitur procesverbale ku as nuk figuronte emri i kryetarit të komunës.

Në fushën e transportit publik, Komuna e Vitisë në njërin nga dy treguesit e vlerësuar nuk e kishte mbështetur me dëshmitë që kërkohen sipas dokumentit kryesor.

Tek treguesi 10.1.2 (Vendbanimet e përfshira në transportin lokal publik) komuna nuk kishte bashkangjitur asnjë dokument.

Në fushën mbrojtja e mjedisit, Komuna e Vitisë në treguesin e vetëm që vlerësohet për këtë fushë nuk kishte arritur që ta mbështesë me dëshmitë e duhura.

Në të dhënat 1 dhe 2 të treguesit 15.1.2, Komuna kishte bashkëngjitur një raport për këto dy të dhëna, por ky raport nuk përmbante asnjë informacion mbi kërkesat për leje mjedisore apo për lejet mjedisore që janë dhënë.

Në fushën e arsimit para universitar, Komuna e Vitisë nga dy treguesit e vlerësuar, njërin nga ta nuk e kishte mbështetur me dëshmitë relevante.

Në treguesin 17.3.5 (Kalueshmëria në maturën kombëtare kl.12-të, ndarja sipas gjinisë), komuna kishte bashkëngjitur raportin e kryetarit të komunës në vend të të dhënave të raportuara nga MASHT për DKA, dokument ky që nuk kërkohet për këtë të dhënë sipas dokumentit kryesor. I njëjti dokument ishte ngarkuar nga komuna edhe për të dhënë 2 të këtij treguesi. Ndërsa për të dhënë 3 komuna nuk kishte bashkëngjitur fare dokument.

Në fushën e zhvillimit ekonomik lokal, Komuna e Vitisë, një nga tre treguesit e vlerësuar nuk e kishte mbështetur me dëshmitë të cilat kërkohen sipas dokumentit kryesor.

Në treguesin 19.1.2 (Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim), Komuna e Vitisë kishte bashkëngjitur dokumente të pavulosura dhe të pa protokolluara në të dy të dhënat e kërkuara të këtij treguesi.

Shkaktarë të kësaj gjendje janë fillimisht mungesa e kontrolleve brenda Komunave e pastaj mungesa e kontrolleve të duhura nga Ministria, si monitoruese e procesit gjate raportimit të performancës komunale, po ashtu edhe në vlerësimin e këtij procesi. Mos funksionimi i duhur i kontrolleve në secilin hap, ka ndikuar edhe në rezultatin e pikëve përfundimtare në rangim dhe si rezultat edhe në shumën e grantit gjatë vlerësimit të komunave për GPK.

3.1.4 Procesi i ankesave për vlerësimin e performancës komunale

Me përfundimin e procesit të vlerësimit të performancës komunale, Ministria dërgon të dhënat e përpunuara te secila komunë individualisht, në afat prej shtatë ditësh komunat kanë të drejtë vërejtjesh ose parashtrim të ankesave rreth rezultateve të performancës komunale, ankesat shqyrtohen nga komisioni i ankesave në përbërje të pesë anëtareve, tre nga Ministria me të drejtë vote dhe dy të tjerë nga shoqëria civile apo donatorët pa të drejtë vote.

Në procesin e vlerësimit të performancës komunale për vitin 2021 nga tre komunat e audituara, Komuna e Gjakovës dhe Komuna e Klinës ishin ankuar për vlerësimin e performancës që iu është bërë nga Ministria.

Komuna e Gjakovës ishte ankuar për tetë tregues. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave i kishte aprovuar ankesën e saj në dy tregues⁸, për dy⁹ tregues tjerë, Komisioni kishte aprovuar pjesërisht ankesën e Komunës ndërsa për katër treguesit e tjerë kishte refuzuar ankesën.

Dy treguesit të cilët Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave i ka aprovuar pjesërisht, janë treguesi 3.3.1 *aktet komunale dhe dokumentet lokale të konsultuara me publikun*, ku dokumenti për njoftimin e KAB është i pavulosur dhe nënshkruar, e që sipas Dokumentit kryesor, një dokument i tillë nuk duhet vlerësuar fare sepse është i pavlefshëm.

Treguesi 8.1.2 *Sipërfaqja e hapësirave publike që mirëmbahen rregullisht*, Komuna e Gjakovës ka ofruar dëshmi shtesë dhe janë aprovuar pjesërisht.

Komuna e Klinës ishte ankuar për 21 tregues ndërsa kishte marrë aprovim vetëm në treguesin 8.1.1 *Sipërfaqja e hapësirave të gjelbra në m² për kokë banori*. Për pesë tregues vlerësimi kishte mbetur ashtu siç ka vlerësuar komisioni për verifikim e performancës komunale, ndërsa për 15 treguesit tjerë kërkesa e Komunës së Klinës ishte refuzuar.

Gjatë shqyrtimit të ankesave në kemi gjetur që komisioni i njëjtë kishte aplikuar standarde të dyfishta të vlerësimit të ankesave. Përderisa për Komunën e Gjakovës për treguesin 9.2.1 *gjatësia e rrugëve të pajisura me trotuar*, ka ndryshuar të dhënën e dytë në përputhje me sqarimet e dërguara nga Gjakova, e njëjta logjikë nuk ishte zbatuar edhe për Komunën e Klinës, ku edhe pse këta të fundit kishin ofruar sqarime, komisioni kishte vendosur që rezultati të mbesë i njëjtë siç ishte vlerësuar nga komisioni për verifikimin e performancës komunale.

Mos konsistenca në vlerësim nga ana e komisionit për Shqyrtimin e Ankesave për Performancën Komunale, ndikon në humbjen e besueshmërisë dhe objektivitetit në procesin e shqyrtimit të ankesave nga ana Ministrisë, e po ashtu ndikon edhe në pikët e fituara apo rangimin për Grantin e Performancës Komunale.

3.1.5 Vlerësimi i Grantit të Performancës Komunale nga grupi teknik

Granti ofrohet në formë të përkrahjes financiare për komunitet dhe ka për qëllim stimulimin e tyre që të përmirësojnë performancën në fusha të caktuara. Të gjitha komunitetet kanë të drejtë pjesëmarrje në grantin e performancës komunale. Qasja në grant fitohet përmes plotësimit të kushteve minimale të përcaktuara në rregullat e grantit. Grupi teknik është organi i nivelit profesional i cili përbëhet nga zyrtarë publik të njësisë përgjegjëse për performancë komunale në të cilin mund të përfshihen edhe donatorët dhe shoqëria civile.

Në vitin 2021 performancën komunale e kishin deklaruar 38 komuna ndërsa vetëm gjashtë¹⁰ prej tyre kanë përmbyshur kriteret minimale dhe janë kualifikuar si përfituese të grantit për performancën komunale.

⁸ Ankesa lidhur me treguesin 11.1.1 Numri i parkingjeve për parkimin e mjeteve motorike, aprovohet dhe Ankesa lidhur me treguesin 9.2.1 Gjatësia e rrugëve të pajisura me trotuar aprovohet.

⁹ Ankesa lidhur me treguesin 3.1.3 Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun aprovohet pjesërisht.

¹⁰ Gjakovë, Gllgovc, Klinë, Lipjan, Obiliq dhe Viti

Grupi teknik ishte themeluar me vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm, ku në përbërjen e tij ishin pesë anëtarë, tre nga Ministria, një nga Helvetas/DEMOS dhe një përfaqësues nga shoqëria civile. Në listat e pjesëmarrësve ku ishte punuar për vlerësimin e GPK-së, ne kemi gjetur se ishin shtatë pjesëmarrës: katër nga Ministria dhe tre nga Helvetas/DEMOS, ndërsa përfaqësuesi nga shoqëria civile nuk ishte prezent, apo të paktën nuk ishte evidentuar në listat e pjesëmarrësve. Vetëm tre nga shtatë zyrtaret e nënshkruar të këtij grupi punues ishin nga ata të autorizuar me vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm.

Arsye për mungesën e njërit nga zyrtaret e autorizuar të Ministrisë ishte pushimi mjekësorë, mirëpo, as për këtë rast nuk kishte ndonjë plotësim ndryshim të vendimit lidhur me përbërjen e grupit.

Pjesëmarrja e anëtarëve pa vendim të Sekretarit të Përgjithshëm, në vlerësimin e GPK-së, vjen si pasojë e mos respektimit të aktit juridik/vendimit të nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm dhe mos koordinimit të duhur të procesit. Vlerësues të angazhuar nga Ministria edhe nga Helvetas/DEMOS të pa autorizuar me vendim nga Sekretari i Përgjithshëm, dhe mungesa e përfaqësuesit të shoqërisë civile mund të cenojë transparencën dhe besueshmërinë e këtij procesi.

Komisioni për vlerësim të GPK-së

Komisioni i GPK-së është organi më i lartë vendimmarrës për grant i cili themelohet me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë, në përbërje nga SP si kryesuese i grupit, një zyrtar publik i nivelit të mesëm drejtues dhe një zyrtar publik nga ministra përgjegjëse për financa.


Komisioni për Grantin e Performancës Komunale ishte në përbërje të tre anëtarëve me të drejtë vote dhe gjashtë anëtarëve të komisionit në cilësinë e vëzhguesve, të cilët ishin përfaqësues nga: Zyra e BE-së në Kosovë, Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë, Agjencia Suedeze, Ambasada Norvegjeze, DEMOS-si dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile. Praktiken e njëjtë të pjesëmarrjes së zyrtarëve/përfaqësuesve të cilët nuk janë në përputhje me vendimin e sekretarit e gjejmë edhe në këtë komision.

Roli kryesor i Komisionit të Grantit të Performancës Komunale është miratimi i rezultateve të GPK-së dhe komunikimi i këtyre rezultateve tek komunat.

Në procesin e analizimit të pjesëmarrjes së zyrtarëve për miratimin e të dhënave nga Komisioni i GPK-së, situatë të njëjtë kemi sikurse tek praktika e grupit teknik. Për deri sa vendimi ka nëntë zyrtarë të përfshirë në këtë proces, në praktikën e miratimit të rezultateve kishin marrë pjesë gjithsej 15 anëtarë, pra gjashtë më shumë se që parashihte vendimi. Për më shumë, Ministria nuk ishte siguruar që ishte prezent zyrtari nga Ministria e Financave, i cili ishte anëtarë me të drejtë vote.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos konfirmimeve me kohë lidhur me pjesëmarrjen e personave të caktuar në bazë të vendimit. Duke e pasur parasysh që janë vetëm tre anëtar me të drejtë vote, mungesa e njërit dhe funksionimi i një komisioni kaq të rëndësishëm me dy anëtarë, rritë rrezikun e kthimit të procesit në piken zero nëse votat për miratim janë një pro dhe një kundër.

Grafiku 1 - Krahasimi i vlerësimit të GPK-së, mes Ministrisë dhe ZKA-së për performancën mesatare




Performanca mesatare e Komunës së Gjakovës në 27 indikatorët e vlerësuar është 40 pikë nga gjithsej 92 pikë të mundshme (57.69 %) sipas Ministrisë ndërsa sipas ZKA-së ka 24 pikë (42.31 %).

Performanca mesatare e Komunës së Klinës në 27 indikatorët e vlerësuar është 46 pikë nga gjithsej 92 pikë të mundshme (65.38%), sipas ZKA 11 pikë (42.31%).

Performanca mesatare e Komunës së Vitisë në 27 indikatorët e vlerësuar është 40 pikë nga gjithsej 92 pikë të mundshme (34.62%), ndërsa sipas ZKA është vlersuar me 2 pikë (7.69%).

Këto ndryshime në vlerësimin mesatar të performancës komunale në mes Ministrisë dhe ZKA-së kanë ndodh për pasojë që përveç ndryshimeve në vlerësimin e dokumenteve, ZKA nga gjithsej 26 tregues të vlerësuar në tre komunat e audituara në pesë prej tyre nuk kishte qasje në dokumentet e publikuara në vegzën elektronike të komunave dhe në pesë të tjerë kishte tejkalim të rezultatit maksimal si pasojë e mos përlogaritjes së duhur të vlerës së treguesit.

Grafiku 2 - Krahasimi i vlerësimit të GPK-së, mes Ministrisë dhe ZKA-së, në fushën “Qeverisja Demokratike”




Performanca mesatare në 12 indikatorët e vlerësuar në kuadër të temës ‘Qeverisja demokratike’ është 17 pikë nga gjithsej 38 pikët të mundshme (44.74 %) sipas Ministrisë ndërsa sipas ZKA është 10 pikë (26.3%);

Performanca mesatare në 12 indikatorët e vlerësuar në kuadër të temës ‘Qeverisja demokratike’ është 21 pikë nga gjithsej 38 pikët të mundshme (55.26%) sipas ZKA është 11 pikë (29%) dhe

Performanca mesatare në 12 indikatorët e vlerësuar në kuadër të temës ‘Qeverisja demokratike’ është 18 pikë nga gjithsej 38 pikët të mundshme (47.37%), ndërsa sipas ZKA kjo fushë ka 9 pikë (24%).

Grafiku 3 - Krahasimi i vlerësimit të GPK-së, mes Ministrisë dhe ZKA-së, në fushën “Menaxhim Komunal”




Performanca mesatare në Komunë e Gjakovës në shtatë indikatorët e vlerësuar në kuadër të temës ‘Menaxhimi Komunal’ është 8 nga gjithsej 28 pikë të mundshme (28.57%) sipas Ministrisë ndërsa sipas ZKA-së kjo pjesë është vlerësuar me gjithsej 7 pikë (26.92%);

Performanca mesatare në Komunën e Klinës në 7 indikatorët e vlerësuar në kuadër të temës ‘Menaxhimi Komunal’ është 13 pikë nga gjithsej 28 pikë të mundshme (46.42%) ndërsa sipas ZKA-së është 2 pike (7.14 %) dhe

Performanca mesatare në 7 indikatorët e vlerësuar në kuadër të temës ‘Menaxhimi Komunal’ është 13 pikë nga gjithsej 28 pikë të mundshme (46.43%) sipas Ministrisë, njëjtë ka vlerësuar edhe ZKA.

Grafiku 4 - Krahasimi i vlerësimit të GPK-së, mes Ministrisë dhe ZKA-së, në fushën “Ofrim i shërbimeve”



Performanca mesatare në 8 indikatorët e vlerësuar Komunën e Gjakovës në kuadër të temës “Ofrimi i shërbimeve” është 15 pikë nga gjithsej 26 pikë të mundshme (57.69%), ndërsa ZKA ka vlerësuar 11 pikë nga 26 pikët e mundshme (42.3%).

Performanca mesatare në 7 indikatorët e vlerësuar në Komunën e Klinës në kuadër të temës ‘Menaxhimi Komunal’ është 8 pikë nga gjithsej 28 pikë të mundshme (28.57%) ndërsa sipas ZKA-së është 11 pikë (42%).

Performanca mesatare në 8 indikatorët e vlerësuar në Komunën e Vitisë në kuadër të temës ‘Ofrimi i shërbimeve’ është 9 pikë nga gjithsej 26 pikë të mundshme (34.62%), ndërsa sipas ZKA ka 2 pikë (8%)

Këto ndryshime në mes vlerësimit nga ana e Ministrisë dhe ZKA-së për rezultatet e Performancës Komunale, vijnë si rezultat që në disa raste Ministria ka pranuar si valide dokumente të pa vulosura, pa protokolluara dhe jo në harmoni me kërkesat e dokumentit kryesor. ZKA ka vlerësuar në përputhje me kërkesat e këtij dokumenti dhe ka ardhur në këto rezultate për GPK-në. Pa saktësia në vlerësimin e performancës komunale me automatizëm bartet edhe në rezultatet finale për rangim të komunave përfituese të Grantit për Performancë Komunale.

3.1.6 Verifikimi në terren pas afateve kohore të parapara

Procesi i verifikimit dhe dokumentimit të treguesve duhet të shpalojë raportimin dhe dokumentimin e duhur të komunave për treguesit e raportuar në terren. Ky proces duhet të dëshmojë nëse MAPL-ja kishte bërë vlerësimin e treguesve të performancës komunale si duhet.

Në tetor të vitit 2022 komunat ishin njoftuar që ishin përfituese të grantit të performancës komunale, ndërsa në mesin e muajit nëntor, Ministri përmes vendimit ka autorizuar Sekretarin e Përgjithshëm që të emëroj komisionin për verifikimin fizik në terren. Sekretari i Përgjithshëm kishte emëruar pesë

anëtarë të rregullt dy prej të cilëve ishin pjesëmarrës në komisionin e vlerësimit të performancës komunale dhe grupit teknik për matjen e GPK-së, dhe dy përfaqësues tjerë nga kabineti i ministrit.

Meqenëse komisioni ishte emëruar jashtë afateve të rregullta për verifikimin fizik në terren në preambulën e vendimit, komisioni autorizohet përmes Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe jo dokumenteve ligjore të cilat rregullojnë funksionimin e sistemit për menaxhimin e performancës komunale. Ndërsa pika 1 e vendimit specifikon se themelohet komisioni për verifikimin e të dhënave gjatë procesit të raportimit për GPK.

Komisioni kishte kryer vizita në gjashtë komunat përfituese të GPK-së, në pesë prej tyre kishte kryer edhe verifikimin fizik, ndërsa Komuna e Vitisë kishte refuzuar një verifikim të tillë me arsyetimin se procesi i GPK-së ka përfunduar dhe një procedurë verifikimi është jo ligjore.

Komisioni kishte verifikuar në terren 16 tregues. Megjithëse komisioni kishte gjetur ndryshime në mes deklarimit dhe gjendjes faktike në terren, këto rezultate nuk ishin reflektuar në rezultatet e GPK-së, të cilat veç se kishin marrë formën përfundimtare dhe komunat përfituese ishin njoftuar për rezultatet. Për më tepër, raporti nuk ishte nënshkruar dhe vulosur nga zyra e Sekretarit të Përgjithshëm apo Ministrit si iniciues i këtij procesi.

Vendimi pas afatit të rregullt për verifikimin fizik në terren kishte rezultuar me një raport i cili nuk ishte nënshkruar dhe vulosur nga Ministria dhe si i tillë nuk kishte asnjë efekt në procesin e GPK-së, kjo për faktin se procesi ishte tashmë i përfunduar.

3.2 Ministria ka mangësi në menaxhimin e autorizimeve për qasje në SMPK

Politikat e qasjes duhet të japin një bazë për kontrollin e ndërhyrjes ndaj informacioneve. Duhet të ekzistojnë ndarje të përgjegjësive dhe kontrole për të parandaluar ndryshimet e paautorizuara në sistemin e informacionit dhe konfigurimin e sistemit.¹¹

Ministria nuk ka zbatuar plotësisht kontrollet për autorizimin e përdoruesve në SMPK. Si rezultat janë gjetur disa mangësi që janë paraqitur në vijim:

Zyrtarët e Departamentit të Performancës dhe Transparencës Komunale (DPTK) kanë krijuar llogari të nivelit të parë "Administrator"¹² në SMPK, pa autorizim, i cili duhet të bëhet me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm. Ky rol mundëson hapjen dhe mbylljen e llogarive të përdoruesve, përcaktimin e roleve dhe përgjegjësive për llogarinë e përdoruesve, konfigurimin e aplikacionit, leximin e raporteve të performancës dhe vlerësimin e raporteve të performancës komunale. Gjatë vitit 2021, janë katër llogari aktive me rolin "Administrator" që kanë kryer aktivitete në sistem. Përdoruesit në Ministri që kanë këtë rol po ashtu janë të angazhuar të bëjnë vlerësimin e

¹¹ Manuali i auditimit të Teknologjisë së Informacionit, matrica e auditimit mbi Sigurinë e Informacionit.

¹² Rregullorja 01/2020 për sistemin e menaxhimit të performancës komunale dhe skemës së grantit për performancë komunale ka definuar kategoritë e nivelit të qasjes. Niveli i parë është roli "Administrator" dhe nuk ka kufizime në sistem dhe i takon përdoruesve të Ministrisë.

performancës komunale. Për më tepër, një nga këto llogari me rolin “Administrator” është shfrytëzuar nga zyrtari i Operatorit Ekonomik (tutje OE) për mirëmbajtjen e SMPK-së. Kjo për shkak që nuk është bërë kërkesë të Sekretari i Përgjithshëm, nga zyrtarët e DPTK-së të bëhet vendimi për autorizimin e zyrtarëve për qasje me këtë rol.

Sipas zyrtarëve, hapja e disa llogarive me rolin “Administrator” është për shkak të nevojës për zyrtar alternativ dhe nevojës për identifikimin e gabimeve nga OE-ja në SMPK.

Kjo ka ndikuar në mos definim të qartë të zyrtarit përgjegjës të Ministrisë për menaxhimin e llogarive në SMPK. Po ashtu, qasja e plotë e OE-së në aplikacionin real të SMPK-së mund të rrezikoj në mbrojtjen e informacionit.

SMPK është e konfiguruar që përdoruesit me rolin “Koordinator komunal i performancës” të kenë mundësinë të krijojnë llogari në sistem për komunën për të cilën janë të autorizuar dhe të caktojnë rolet për këto llogari. Ky rol gjithashtu ka mundësinë të përcaktojë rolin shtesë të “Kryetar komune”, i cili ka autorizimin e aprovimit final të të dhënave të raportuara të Komunës në sistem dhe dërgimit të të dhënave në Ministri. Megjithatë, duhet theksuar që krijimi i këtyre llogarive duhet të realizohet vetëm me autorizim të Kryetarit të Komunës dhe përgjegjës për hapjen e llogarive është njësia përgjegjëse për menaxhimin e performancës komunale të Ministrisë. Si pasojë e këtij procesi të konfiguruar në SMPK-së, vetëm 22 kryetar të komunave kanë kryer aktivitete në SMPK për raportimin e performancës komunale.

Deklarata e konfidencialitetit nuk është zbatuar për përdoruesit të cilët kanë qasje në SMPK, të cilët nuk janë zyrtar të Ministrisë apo komunave, që siguron përdorimin e të dhënave vetëm mbi bazën e autorizimit. Ky moszbatim i deklaratës së konfidencialitetit vjen si rezultat që palët e donatorit shihen si bashkëpunëtorë të procesit në vlerësimin e performancës komunale. Moszbatimi i deklaratës së konfidencialitetit nga palët e treta, të cilat kanë qasje në SMPK, paraqet rrezik për shpalosjen e informacionit zyrtar të komunave.

Në SMPK kanë krijuar llogari jo të standardizuara dhe jo të personalizuar të cilat vështirësojnë identifikimin e zyrtarit nga i cili janë realizuar këto aktivitete. Këto llogari jo të personalizuar kanë rolin “Administrator” apo “Zyrtar MAPL” të cilat janë përdorur për të kryer aktivitete në sistem gjatë procesit të vlerësimit të performancës komunale për vitin 2021. Këto llogari përdoren nga OE-ja dhe nga zyrtarët e Ministrisë. Kjo ka ndodh për shkak se zyrtarët e Ministrisë që administrojnë aplikacionin nuk kanë njohuri të standardeve të Teknologjisë së Informacionit-së¹³, e që duhet të ndiqen për krijimin e llogarive elektronike në sisteme. Përdorimi i llogarive jo të personalizuar vështirëson identifikimin nga cili zyrtarë është realizuar aktiviteti, pasi që këto llogari mund të përdoren nga më shumë se një përdorues.

Ka llogari në SMPK e cila nuk është pasvizuar edhe pas vendimit për ndryshim të zyrtarit komunal për raportim të performancës komunale me vendim të Kryetarit të Komunës së Klinës. Po ashtu, ka llogari që janë aktive dhe nuk janë kyçur në sistem më shumë se dy vite. Kjo ka ndodhur për shkak

¹³ Udhëzimit Administrativ (MAP) 02/2015 për llogaritë elektronike zyrtare ka të definuar që llogaritë elektronike duhet të jenë emër.mbiemër.

të mos rishikimit periodik të të drejtave të qasjes për llogaritë e përdoruesve në sistem, për t'u siguruar që ato mbesin në përputhje me vendimet e autorizimit për qasje në SMPK. Mos pasivizimi i llogarive në sistem mund të ketë ndikim në raportim të paautorizuar në sistem apo ndryshim të të dhënave të raportuara për komunën.

Mungesa e zbatimit të plotë të Rregullores 01/2020 për sistemin e menaxhimit të performancës komunale dhe skemës së grantit për performancë komunale, si dhe Udhëzimit Administrativ (MAP) 02/2015 për llogaritë elektronike zyrtare ka shkaktuar një menaxhim jo të mirë të kontrollit të qasjeve të llogarive të përdoruesve në SMPK. Si pasojë, mungesa e zbatimit të kontrolleve mund të rrezikojë integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave.

3.2.1 Mangësi në menaxhimin e fjalëkalimeve në SMPK

Në sistemin e informacionit duhet të konfigurohen kriteret e përcaktuara për menaxhimin e fjalëkalimit. Përdoruesi i llogarisë zyrtare obligohet që menjëherë pas aktivizimit të saj, ta ndryshoj fjalëkalimin fillestar me fjalëkalim kompleks (të paktën 8 karaktere), që duhet të jetë kombinimi i shkronjave, numrave dhe simboleve¹⁴.

SMPK nuk është i konfiguruar në mënyrë që të detyrojë përdoruesin të ndryshojë fjalëkalimin pas aktivizimit të llogarisë dhe qasjes së parë në sistem. Administratori i SMPK-së krijon llogarinë për përdoruesin duke përdorur kredencialet (username/përdoruesi dhe fjalëkalimi). Fjalëkalimi në hapjen e llogarisë fillimisht është i përcaktuar nga administratori i sistemit dhe është i njëjtë për të gjitha llogaritë. Nga testet e realizuara për qasje në SMPK me kredencialet e përdoruesve të komunave është identifikuar që disa zyrtarë nuk kanë ndryshuar fjalëkalimin dhe vazhdojnë të përdorin atë fjalëkalim. DPTK-ja ka këshilluar ta ndryshojnë fjalëkalimin pas qasjes së parë në sistem.

Gjithashtu, numri i karaktereve të fjalëkalimit në sistem ishte i konfiguruar të paktën me gjashtë karaktere, ndërsa UA 02/2015 për llogari elektronike zyrtare kërkon të paktën tetë karaktere. Kjo për shkak që zyrtarët e Ministrisë të cilët administrojnë sistemin, nuk njohin standardin për siguri të informacionit dhe nuk kanë kërkuar konfigurimin e sistemit sipas kërkesave të paracaktuara me Udhëzimin Administrativ.

Mos konfigurimi i kriterëve për fjalëkalime në SMPK rrezikon keqpërdorimin e llogarive të përdoruesve dhe humbjen e integritetit dhe konfidencialitetit të të dhënave të raportuara.

3.2.2 Kufizimi i raportimit të performancës komunale sipas SMPK

Të drejtat e vendosjes së të dhënave dhe aprovimit të tyre në SMPK për të gjithë përdoruesit e komunave duhet të ndërpriten në momentin e ndërprerjes së periudhës kohore të raportimit të performancës komunale.

Ministria për të vlerësuar performancën komunale ka zhvilluar sistemin e informacionit " Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale". Kjo platformë mundëson mbledhjen dhe raportimin e të dhënave nga zyrtarët raportues dhe koordinatorët e performancës komunale, duke përfshirë

¹⁴ Rregullore nr. 02/2015 për llogaritë elektronike zyrtare.

aprovimin e tyre nga Kryetari i Komunës. Pas kësaj faze, të dhënat transferohen në Ministri për vlerësim të performancës komunale.

Nëpërmjet këtij sistemi Ministria bënë kërkesën për raportim nga komunat dhe njofton zyrtarët komunal për këtë proces. Në sistem caktohet afati kohor për raportim, i njëjtë për të gjitha komunat. Në raste të veçanta, afati kohor ka mundësi të ndryshohet në sistem për të gjitha komunat. Duhet të theksohet, që në SMPK nuk ka mundësi shtyrje të afatit vetëm për një llogari të përdoruesit/zyrtari të komunës. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar nga Ministria, SMPK mbyllet për raportim për komunat. Pas kësaj faze, përdoruesit e autorizuar kanë privilegjin vetëm për të lexuar të dhënat e raportuara. Në sistem proceset e raportimit nga komunat janë të konfiguruar në përputhje me rregulloren 02/2020, e cila e përcakton afatin kohor të raportimit. Gjatë kohës së raportimit zyrtarët e caktuar për raportim komunal së bashku me koordinatorin kanë të drejtë raportimit.

4. Konkluzionet

Përkundër progresit dhe masave të ndërmarra nga komunat për organizimin e brendshëm në deklarin e performancës komunale, mos evidentimi i komunikimit të zyrtarëve përgjegjës, mos aprovimi i të dhënave nga kryetarët përkatës, mos shpërndarja proporcionale e detyrave mes zyrtarëve raportues, tregon që mekanizmat e kontrollit për sigurimin e cilësisë për të dhënat e raportuara nuk ishin funksionale në komunat e audituara.

Fakti që ka procese të raportimit ku mungojnë dëshmitë e komunikimit mes zyrtarëve raportues, koordinatorëve komunal dhe kryetarit të komunës, tregon që deklarimi i performancës komunale nuk është i bazuar në të dhëna të kontrolluara, të verifikuara dhe të miratuara nga kryetarët e komunave.

Mos performimi i vlerësimit paraprak nga Ministria, pranimi i dokumenteve të pa protokolluara, pranimi i vlerësimeve që nuk ishin miratuar nga kryetarët e komunave përkatëse dhe dallimet në pikët e dhëna nga Ministria dhe ZKA, tregon se mekanizmat e vendosur nga Ministria për të siguruar cilësi në raportimin e të dhënave të performancës komunale nuk ishin efektive, e për më tepër këto rezultate kanë ndikuar edhe në rangimin e gabuar të komunave të audituara.

Mos respektimi i vendimeve për komisionet e themeluara për vlerësimin e procesit të Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale, lejimi i pjesëmarrjes së zyrtarëve të cilët nuk ishin të autorizuar me vendim, pjesëmarrja e zyrtarëve nga njësi përgjegjëse në të gjitha hallkat e procesit dhe mungesa e atyre që ishin të autorizuar dhe kishin të drejtë vote, rrezikon cenimin e transparencës dhe besueshmërisë së këtyre proceseve.

Ministria nuk ka arritur të siguroj që qasje në SMPK të kenë vetëm përdoruesit e autorizuar ndaj informacioneve. .

Ministria ka mangësi në menaxhimin e autorizimit të përdoruesve në SMPK. Nuk ka zbatuar rregulloren 01/2020 për SMPK dhe skemën e GPK-së për menaxhimin e niveleve/roleve në sistem. Janë krijuar llogari të nivelit të parë "Administrator" pa autorizimin e Sekretarit të Përgjithshëm. Po ashtu, në SMPK roli "koordinator komunal i performancës" për komunën e autorizuar lejon krijimin e llogarive në sistem. Zyrtarët me këtë rol kanë rolin shtesë "Kryetar komune" me të drejtë për aprovim final të raportit të performancës komunale. Këto qasje të paautorizuara paraqesin rrezik në integritetin e informacionit. Gjithashtu, moszbatimi i deklaratës së konfidencialitetit të nënshkruar nga përdoruesit që kanë qasje në sistem dhe nuk janë zyrtarë të Ministrisë apo komunave rrezikon shpалosjen e informacionit.

Zyrtarët që administrojnë SMPK-në kanë mungesë të njohurive të standardeve në krijimin e llogarive dhe nuk praktikojnë rishikimin periodik të llogarive. Llogaritë jo të personalizuar vështirësojnë identifikimin e zyrtarit dhe mos pasivizimi i llogarive mund të ndikojë në qasje të paautorizuara dhe manipulim të të dhënave të raportuara në sistem. Për derisa, moszbatimi i rregullave dhe standardeve për sigurinë e fjalëkalimit në SMPK nuk garanton sigurinë e llogarive të përdoruesve nga keqpërdorimi. Këto mangësi rrezikojnë integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave në sistemin e informacionit.

5. Rekomandimet

Rekomandimet e mëposhtme kanë për qëllim që të përmirësojnë procesin e raportimit dhe vlerësimin të deklarimit të performancës komunale, vlerësimin të GPK-së dhe përmirësimin e efektivitetit të tërë procesit.

Rekomandimet për Komunat

Komunat të sigurohen në:

- Përcaktimin e kanaleve të qarta të komunikimit ndërmjet zyrtarëve raportues, koordinatorëve komunalë dhe kryetarëve të komunave për të siguruar një deklaram transparent dhe të përgjegjshme të performancës komunale;
- Krijimi i një procesi sistematik për miratimin e të dhënave të raportuara nga kryetarët e komunave, duke theksuar rëndësinë e rolit të tyre në miratimin e të dhënave të raportuara; dhe
- Zhvillimi dhe zbatimi i mekanizmave efektivë të kontrollit për sigurimin e cilësisë në të dhënat e raportuara, duke adresuar çështje të tilla si shpërndarja proporcionale e detyrave ndërmjet zyrtarëve raportues dhe sigurimi i dëshmive të komunikimit gjatë gjithë procesit të raportimit.

Rekomandimet për Ministrinë

Ministria të sigurohet në:

- Adresimin e mangësive në proceset e pranimit dhe vlerësimin të të dhënave të raportuara nga komunat të cilat duhet të jenë të plota, të sakta dhe të miratuara nga kryetarët e komunave;
- Zbatimin e pajtueshmërisë me vendimet e marra nga komisionet që vlerësojnë Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale, duke siguruar pjesëmarrjen e autorizuar dhe duke parandaluar përfshirjen e zyrtarëve të paautorizuar. Kjo do të ruajë transparencën dhe besueshmërinë e procesit të vlerësimin;
- Vlerësimin e verifikimit fizik në procesin e vlerësimin të performancës komunale në mënyre që të parandaloj deklarimin e gabuar dhe pa dëshmi.
- Të zbatohet Rregullorja 01/2020 për SMPK dhe skemën e GPS-së lidhur me autorizimet e qasjeve në SMPK sipas nivele. Për administrimin e aplikacionit të SMPK-së të caktojë një zyrtar të përhershëm dhe një zyrtar alternativ dhe këta zyrtarë nuk duhet të jenë të përfshirë në procesin e vlerësimin të performancës komunale.
- OE-së t'i pasivizohet llogaria për qasje të plotë në aplikacion real përveç qasjeve vetëm për lexim, me vendim të veçantë dhe mbikëqyrje nga ana e Ministrisë;

- Në SMPK të bëhet konfigurimin për të kufizuar përdoruesin me rolin “ Koordinator i performancës komunale” të menaxhojë llogaritë e përdoruesve të Komunës në sistem, si dhe konfigurimi për t’i detyruar përdoruesit të ndryshojnë fjalëkalimin pas aktivizimit të llogarisë dhe qasjes së parë në sistem dhe numri i karaktereve të fjalëkalimit të jetë kompleks me të paktën tetë (8) karaktere;
- Ministria në SMPK të pasivizojë llogaritë jo të personalizuara dhe krijimi i llogarive të jetë i standardizuar dhe i personalizuar. Të rishikojë të drejtat e qasjes së përdoruesve të SMPK-së në baza periodike për t’u siguruar që ato janë të vlefshme sipas vendimeve të Ministrisë dhe Komunës dhe
- Organizimi i trajnimeve për zyrtarët që menaxhojnë llogaritë në SMPK mbi standardet për krijimin e llogarive elektronike dhe proceset e rishikimit periodik.

Shtojca I Kriteret, fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Kriteret e auditimit

Performanca Komunal vlerësohet për 19 fusha dhe 119 tregues, ndërsa vlerësimi i Grantit për Performancë Komunale vlerësohet me 28 tregues të performancës komunale të grupuara në tre fusha kryesore dhe dhjetë nën-fusha. Fushat kryesore janë: Qeverisja Komunale¹⁵ me 14 tregues të vlerësuar; Menaxhimi Komunal¹⁶ me gjashtë tregues të vlerësuar dhe Ofrimi i Shërbimeve¹⁷ me tetë tregues të vlerësuar.

Për t'iu përgjigjur objektivave dhe pyetjeve të auditimit, ne kemi përcaktuar këto kriteret:

- Komunitat janë përgjegjëse¹⁸ për të krijuar parakushtet për funksionimin efikas të SMPK-së, duke siguruar bashkëpunimin me MAPL, mbledhjen, raportimin, verifikimin dhe miratimin e të dhënave për performancën e komunës.
- Organet përgjegjëse¹⁹ në komunë për verifikimin e saktësisë së të dhënave janë koordinatori dhe kryetari i komunës i cili siguron se janë përmbushur të gjitha kriteret për sigurinë e cilësisë së të dhënave;
- Kryetari i Komunës është instanca më e lartë vendimmarrëse për SMPK në nivelin komunal, me vendim cakton koordinatorin dhe zyrtarët komunal për raportim të performancës komunale, gjithashtu bën miratimin e tërësisë së të dhënave për performancë komunale para raportimit në Ministri;
- Ministria është përgjegjëse për verifikimin e të dhënave pas raportimit të komunave dhe ky proces duhet të përfundojë para procedurës së konsultimit paraprak, njësia për performancë është përgjegjëse për hartimin e raportit për procesin e verifikimit të dhënave, formë tjetër e verifikimit mund të aplikohet në pajtim me Dokumentin Kryesor për SMPK. Në këtë fazë MAPL-ja në bashkëpunim me komunitat mund të përmirësojë të dhënat për të cilat janë raportuar gabimisht dhe komunitat kanë fakte lidhur me ndryshimin, ky proces ndodh gjatë fazës së konsultimit paraprak;
- Politikat e qasjes duhet të japin një bazë për kontrollin e ndërhyrjes ndaj informacioneve. Duhet të ekzistojnë ndarje të përgjegjësive dhe kontrole për të parandaluar ndryshimet e paautorizuara në sistemin e informacionit dhe konfigurimin e sistemit; dhe

¹⁵ Fusha 3. Përgjegjshmëria Komunale dhe Fusha 2. Transparenca Komunale;

¹⁶ Fusha 19. Zhvillimi Ekonomik Lokal; Fusha 16. Përfaqësimi Gjinnor dhe 3. Përgjegjshmëria Komunale;

¹⁷ Fusha 1. Shërbime publike administrative; Fusha 15. Mbrojtja e Mjedisit; Fusha 7. Planifikimi Hapësinorë Komunal, Fusha 10 Transporti publik; Fusha 17 Arsimit para universitar dhe Fusha 18. Kujdesi Parësor Shëndetësor.

¹⁸ Rregullore nr.01/2020 për SMPK neni 7 pika 1 deri 4.

¹⁹ Po aty, neni 7.

- Të drejtat e vendosjes së të dhënave dhe aprovimit të tyre në SMPK për të gjithë përdoruesit, kontraktuesit apo palët e treta duhet të ndërpriten në momentin e ndërprerjes së periudhës kohore të raportimit të performancës komunale.

Fushëveprimi i auditimit

Fushëveprimi i këtij auditimi ka përfshirë raportimin e komunave për vitin 2021. Subjektet e audituara janë MAPL dhe tre komuna: Gjakovë, Viti dhe Klinë.

Komunat janë përzgjedhur bazuar në dy kritere, si në vijim:

- Përfitues i Grantit për Performancë Komunale, dhe
- Madhësia e komunës në aspektin e buxhetit.

Komunat e përzgjedhura nga këndvështrimi i buxhetit kategorizohen në dy nivele:

- komunat²⁰ që kanë buxhet vjetor mbi 10 milion euro; dhe
- komunat²¹ që kanë buxhet vjetor mbi 20 milion euro.

Fokusi i këtij auditimi është në 28 tregues të grumbulluar në tri fusha:

1. Qeverisje Demokratike;
2. Menaxhim Komunal; dhe
3. Ofrim i Shërbimeve – (në të gjitha proceset) lidhur me raportimin e performancës komunale, vlerësimin këtyre treguesve në performancë komunale dhe vlerësimin që është bërë për Grantin e Performancës Komunale.

Metodologjia e auditimit

Metodologjia e auditimit përfshin ekzaminimin e dokumentacionit si pjesë e dosjes për deklarimin e performancës komunale me fokus në vlerësimin e mekanizmave të kontrollit brenda komunës dhe vlerësimin e treguesve nga MAPL-ja, për të audituar këto, ne kemi:

- Analizuar rolin e koordinatorëve dhe zyrtarëve të përfshirë në raportimin e performancës komunale;
- Analizuar pikat të kontrollit në mes zyrtarëve raportues, koordinatorit të performancës komunale dhe kryetarit të komunës;
- Analizuar politikat dhe procedurave të hartuara për menaxhimin e qasjeve të përdoruesve në sistemet e informacionit;

²⁰ Komuna e Vitisë dhe Klinës

²¹ Komuna e Gjakovës

- Vlerësuar qasjen logjike në aplikacion SMPK dhe bazën e të dhënave të sistemit: llogaritë aktive dhe pasive, rishikimi periodik i përdoruesve, përcaktimi i kufizimit të raportimit në sistem, rolet dhe privilegjet e përdoruesve;
- Kontrolluar konfigurimin e autentifikimit (emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi);
- Analizuar gjurmueshmërinë në SMPK-së;
- Analizuar vendosjen së të dhënave për vitin 2021 për të vlerësuar se futja dhe aprovimi i tyre në SMPK janë realizuar nga zyrtarët e autorizuar sipas vendimeve komunale; dhe
- Zhvilluar intervistat me zyrtarët përgjegjës.

Problemi i auditimit

Nisur nga problemet e identifikuara nga raportet e vlerësimit të performancës komunale, si dhe gjetjet e raporteve të auditimeve të mëparshme të këtij procesi, ZKA-ja, me kërkesë të Helvetas ka vendosur ta kryej këtë auditim. Kjo iniciativë vjen si rezultat i vazhdueshëm në ndikimin e përmirësimit të sistemeve përmes dhënies së rekomandimeve. Në fokusin e raporteve të mëparshme ishin procedurat e prokurimit dhe menaxhimi i projekteve ndërsa tani në këtë raport fokusi është në funksionalitetin e mekanizmave për sigurimin e cilësisë së të dhënave të raportuara.

Komunat janë përgjegjëse për raportim të saktë dhe të plotë përmes Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK). MAPL ka zhvilluar këtë sistem të informacionit që përdoret për të vlerësuar performancën komunale të çdo viti, e cila pasqyrohet në raportin e performancës të hartuar nga MAPL-ja. Nëpërmjet këtij sistemi realizohet mbledhja dhe raportimi i të dhënave nga zyrtarët raportues dhe koordinatorët e performancës komunale.


Gjatë punës hulumtuese në fazën e planifikimit të auditimit kemi vërejtur disa mangësi si:

- të dhënat e regjistruara në SMPK nuk mbështeten mjaftueshëm me dëshmi relevante;
- vlerësimi i treguesve të performancës komunale është i shoqëruara me disa dobësi; dhe
- menaxhimi jo i duhur i qasjes logjike me qëllim të ruajtjes së integritetit të dhënave në SMPK.

Përshkrimi i sistemit dhe akterët relevant

Komunat e fillojnë procesin e plotësimit të formularit për vitin e kaluar në vitin aktual dhe kohëzgjatja e raportimit është 45 ditë. Pas këtij afati kohor, qasja në sistem për ta lejohet vetëm për pamje/raportim.

Akterët e përfshirë në deklarin e performancës komunale janë Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal si zhvilluese, monitoruese dhe vlerësuese e sistemi dhe komunat e Kosovës si deklarues të performancës komunale. Procesi është paraqitur në diagramin e më poshtëm:



Siç shihet në diagram, procesi i matjes së performancës fillon me njoftimin që MAPL-ja u dërgon komunave për deklarimin e performancës komunale, komunat përgatiten përmes koordinatit dhe zyrtareve për performancë komunale për të raportuar për fushat që u kërkohet. Detajet e proces janë paraqitur në diagram.

Shtojca II Tabelat e krahasimit të vlerësimit mes Ministrisë dhe ZKA-së

Komuna	Cikli i katër i vlerësimit - performanca e vitit 2021																
	1. Qeverisja Demokratike																1. Total
	I						II					III					
	IP1	IP2	IP3	IP4	IP5	Tot I	IP6	IP7	IP8	Tot II	IP9	IP10	IP11	IP12	IP13	Tot III	
Gjakovë	0	3	0	0	2	5	0	2	4	6	0	4	2	0	0	6	17
Klinë	2	3	0	2	1	8	0	4	4	8	0	4	1	0	0	5	21
Viti	2	3	0	2	1	8	0	2	4	6	0	2	2	0	0	4	18

Vlerësimi ZKA

Komuna	Cikli i katër i vlerësimit - performanca e vitit 2021																
	1. Qeverisja Demokratike																1. Total
	I						II					III					
	IP1	IP2	IP3	IP4	IP5	Tot I	IP6	IP7	IP8	Tot II	IP9	IP10	IP11	IP12	IP13	Tot III	
Gjakovë	0	3	0	2	0	5	0	1	0	1	0	2	2	0	0	4	10
Klinë	2	0	0	2	0	4	0	0	4	4	0	2	1	0	0	3	11
Viti	2	0	0	2	0	4	0		0	0	2	2	1	0	0	5	9

Vlerësimi nga Ministria											
2. Menaxhimi komunal											2. Total
IV			V			VI			Tot VI		
IP14	IP15	IP16	Tot IV	IP17	IP18	Tot V	IP19	IP20		IP21	
0	1	0	1	1	0	1	0	5	1	6	8
3	0	2	5	3	0	3	0	0	0	0	8
3	0	1	4	3	4	7	0	2	0	2	13

Vlerësimi nga ZKA											
2. Menaxhimi komunal											2. Total
IV			V			VI			Tot VI		
IP14	IP15	IP16	Tot IV	IP17	IP18	Tot V	IP19	IP20		IP21	
3		1	4		0	0	0	3	0	3	7
		1	1		0	0	0	0	1	1	2
3	1	1	5	3	0	3	0	2	3	5	13

Ngjyra e kuqe në tabelë paraqet kufizim të fushëveprimit tonë.

Vlerësimi nga Ministria													
3. Ofrimi i shërbimeve													
VII			VIII				IX			X			3. Total
IP22	IP23	Tot VII	IP24	IP25	IP26	Tot VIII	IP27	IP28	Tot IX	IP29	IP30	Tot IX	
4	2	6	0	1	1	2	0	2	2	0	5	5	15
4	2	6	0	3	0	3	0	4	4	1	3	4	17
4	0	4	0	1	0	1	0	2	2	1	1	2	9

Vlerësimi nga ZKA													
3. Ofrimi i shërbimeve													
VII			VIII				IX			X			3. Total
IP22	IP23	Tot VII	IP24	IP25	IP26	Tot VIII	IP27	IP28	Tot IX	IP29	IP30	Tot IX	
4	0	4		0	0	0	0	2	2	0	5	5	11
4		0	3	0	0	3	0	4	4	1	3	4	11
4		0	0	0		0	0	0	0	1	1	2	2

Shtojca III – Matja e 27 treguesve në Performancë Komunale

Komuna e Gjakovës

Përgjegjshmëria Komunale		Gjakove		
		MAPL	Komunë	ZKA
I. Roli i kuvendit komunal si organ mbikqyres				
Treguesi : 3.2.1	Miratimi me kohë i propozim buxhetit vjetor komunal	30	100	30
Treguesi : 3.2.2	Diskutime për raportet buxhetore tre-mujore nga Kuvendi Komunal	75	100	75
Treguesi : 3.2.3	Diskutim për raportin e performancës komunale nga kuvendi komunal për vitin paraprak	0	0	0
Treguesi : 3.2.4	Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresim të rekomandimeve	50	50	50
Treguesi : 3.2.6	Mbledhje të Kuvendit me pjesëmarrje të kryetarit të komunës	100	100	0
II. Pjesëmarrja, konsultimi dhe gjithëpërfshirja e qytetarëve				
Treguesi : 3.1.2	Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike	6.56	52.87	6.41
Treguesi : 3.1.3	Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun	80	100	60
Treguesi : 3.1.4	Dëgjime publike për KAB dhe buxhet komunal	100	100	0
III. Transparenca, qasja në informata dhe integriteti				
Treguesi : 2.1.1	Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe të transmetuara drejtpërdrejt online	20	100	0
Treguesi : 2.1.3	Përbushja e kriterëve të faqes zyrtare elektronike të komunës	100	100	62.5
Treguesi : 2.2.2	Publikimi i dokumenteve të prokurimit publik dhe i kontratave	100	100	100
Treguesi : 3.1.5	Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike	0	100	0
Treguesi : 3.4.1	Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit para kuvendit komunal	0	0	0
II. MENAXHIMI KOMUNAL - Menaxhimi financiar, Menaxhimi i kontratës dhe Menaxhimi i BNj				
IV. Menaxhimi Financiar				
Treguesi : 19.1.3	Niveli i azhurnimit të regjistrimit të tatimit në prone	66.43	77.32	77.32
Treguesi : 19.1.4	Niveli i mbledhjes së faturës së tatimit në pronë (pa borxhe, interesa, ndëshkime)	50.9	100	102.72
Treguesi : 3.3.3	Niveli i zbatimit të rekomandimeve të ZKA	20	60	45
V. Menaxhimi i Kontratave				
Treguesi : 3.3.1	Niveli i zbatimit të planit të prokurimit	67.99	67.99	133.24
Treguesi : 19.1.2	Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim	0	100	0
VI. Menaxhimi i burimeve nje				
Treguesi	Vende të hapura pune të proceduara përmes SIMBNj			
Treguesi : 16.1.2	Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore dhe kulturore/sportive	81.37	81.37	81.37
Treguesi : 16.1.3	Gratë e emëruara në poste politike në komunë	82.35	82.35	82.35
III. OFRIMI I SHËRBIMEVE - Qasja dhe cilësia e ofrimit të shërbimeve - Sipas sektorit				
VII. Shërbimet administrative				
Treguesi : 1.1.2	Rastet e kërkesave administrative të shqyrtuara brenda afateve ligjore	100	100	100
Treguesi : 7.2.1	Kerkesat e shqyrtuara për lejet e ndërtimit	93.63	100	0
VIII. Planifikimi hapësinor, transporti publik dhe mjedisi				
Treguesi : 7.1.1	Sipërfaqja e territorit të komunës e mbuluar me plane rregulluese (të hollësishe)	3.79	4.06	
Treguesi : 10.1.2	Vendbanimet e përfshira në transportin lokal public	63.73	63.73	0
Treguesi : 15.1.1	Realizimi i planit lokal të veprimit në mjedis	83.33	83.33	0
IX. Arsimi para-universitar				
